

**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**  
**SOUTH-EAST EUROPEAN UNIVERSITY**  
**УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА**



**FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË**  
**FACULTY OF BUSINESS AND ECONOMY**  
**ФАКУЛТЕТ ЗА БИЗНИС И ЕКОНОМИЈА**

**ЦИКЛИ I DYTË – STUDIME POSTDIPLOMIKE**

**TEZË MASTERI**

**ANALIZA E PASQYRAVE FINANCIARE TË INSTITUCIONIT PUBLIK**  
**SHËNDETËSOR SHTËPIA E SHËNDETIT-GOSTIVAR PËR PERIUDHËN**  
**(2017-2021)**

**KANDIDATI:**  
**Vullnet Ollomani**

**Mentori:**  
**Prof.dr.Rufi Osmani**

**Tetovë, 2023**

## DEKLARATË

Unë, Vullnet Ollomani, student në studimet e masterit në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë, pranë Universitetit të Evropës Juglindore, vërtetoj se unë jam autori origjinal i këtij punimi me titull: Analiza e pasqyrave financiare të intsitucionit publik shëndetësor Shtëpia e Shëndetit-Gostivar për periudhëm (2017-2021)

.

Tetovë, 2023

Kandidati \_\_\_\_\_

## ABSTRAKTI

Duke marrë parasysh se sistemi shëndetësor është një ndër sistemet më të rëndësishme të shoqërisë në një vend, qëllimi kryesor i të cilit është të përmirësojë dhe ruajë shëndetin e njeriut. Gjithashtu si institucion publik shëndetësor përbëjmë mbrojtjen shëndetësore primare të popullatës duke marrë parasysh se një sistem efikas i kujdesit shëndetësor është thelbësor për zhvillimin e suksesshëm të shoqërisë.

Zhvillimi teknologjik dhe socio-ekonomik inkurajon forcimin e sistemit shëndetësor, i cili nga ana e tij çon në përmirësimin e shëndetit të popullatës.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të bëjë analizën e pasqyrave financiare dhe strukturore në bazë të njësive të Institucionit publik shëndetësor Shtëpia e Shëndetit-Gostivar për vitet 2017-2021. Ky institucion është i financuar nga mjetet buxhetore dhe ato vetanake, si financues i këtyre shërbimeve është Fondi Shëndetësor i RMV-së, gjithashtu matjen e performancës dhe efikasitetit të funksionimit si institucion shëndetësor që mbulon shërbime primare dhe sekondare shëndetësore për qytetarët.

Qëllimi bazë i këtij punimi është analizimi i pasqyrave financiare si dhe analiza e performancës financiare të njësive organizative dhe të institucionit publik shëndetësor Shtëpia e Shëndetit-Gostivar prej vitit 2017-2021 .

Analiza synon të jep përgjigje bazike në hipotezën kryesore dhe hipotezat ndihmëse në kuptim të konstatimit të shkaqeve për performancën financiare asimetrike të njësive organizative (disa punojnë me fitim dhe të tjera me humbje) përkundër faktit se institucioni publik shëndetësor Shtëpia e Shëndetit-Gostivar gjatë periudhës së analizuar 2017-2021 tregon rezultat financiar pozitiv.

Punimi synon të rekomandojë reforma financiare dhe organizative në kuptim të tejkalimit të pozicioneve problematike në Bilancin e Gjendjes dhe rritjen e financimit nga Fondi Shëndetësor për shërbimet e domosdoshme shëndetësore ose instalimin e participimit financiar nga qytetarët dhe subjektet që deri tash kanë shfrytëzuar falas këto shërbime shëndetësore që janë përgjegjësi e njësive organizative dhe shtëpisë së shëndetit.

Autori rekomandon që krahas stabilizimit financiar duhet të rriten investimet kapitale të cilat kanë nivele minimale në rritjen e investime me teknologji të re moderne në objekte dhe në veçanti në pajimet shëndetësore në funksion të realizimit të shërbimeve shëndetësore më cilësore dhe në kohë ndryshime në rritjen e cilësive së resurseve humane (personel mjekësor të ri dhe të kualifikuar ). Autori mban bindjen se ky studim i parë në këtë institucion nxjerr në sipërfaqe dobësitë organizative dhe financiare dhe rekomandon alternativë për avansim të performancës së institucionit në fjalë.

## АПСТРАКТ

Имајќи предвид дека здравствениот систем е еден од најважните системи на општеството во една земја чија основна цел е подобрување и одржување на здравјето на луѓето. Исто така, како јавна здравствена установа ја сочинуваме примарна здравствена заштита на населението, имајќи предвид дека ефикасен здравствен систем е суштински за успешен развој на општеството. Технолошкиот и социо-економскиот развој го поттикнува зајакнувањето на здравствениот систем, што пак води кон подобрување на здравјето на населението.

Основната цел на овој труд е да ги анализира финансиските и струкурните извештаи на организационите единици на јавната здравствена установа Здравствен Дом-Гостивар за годините 2017-2021 година. Оваа институција се финансира од сопствени ресурси како и од буџетски средства по основ на реализација на здравствени услуги, бидејќи финансиер на овие услуги е Фондот за Здравство на РСМ, како и мерењето на успешноста и ефикасноста на работењето како здравствена установа која ги покрива примарните и секундарните услуги здравје за граѓаните.

Трудот има цел и ќе препорача во Билансот на државата и зголемување на средствата од Фондот за здравство за потребите на здравствени услуги или инсталирање финансиско учество од страна на граѓаните и субјектите кои користеле овие услуги досега бесплатно здравје кои се во надлежност на организациските единици и здравствените домови.

Авторот препорачува, покрај финансиската стабилизација, да се зголемат и капиталните инвестиции кои имаат минимални нивоа во зголемувањето на инвестициите со нова современа технологија, капацитети и особено во здравствена опрема во функција на реализација на најважните здравствени услуги и во временски промени во зголемувањето на квалитетот на човечките ресурси (млад квалификуван медицински персонал).

Авторот смета дека оваа студија, прва од овој вид за ова институција ги открива финансиските и организациските слабости и препорачува алтернативи за унапредување на работата на предметната институција во перспектива.

## **ABSTRACT**

Considering that the health system is one of the most important systems of society in a country whose main goal is to improve and maintain human health. Also, as a public health institution, we constitute the primary health protection of the population, taking into account that an efficient health care system is essential for the successful development of society.

Technological and socio-economic development encourages the strengthening of the health system, which in turn leads to the improvement of the health of the population.

The main purpose of this paper is to analyze the financial and structural statements based on the units of the public health institution Gostivar Health House for the years 2017-2021. This institution is financed from its own resources as well as from budget resources based on the realization of health services, as the financier of these services is the Health Fund of the Ministry of Health, also the measurement of the performance and efficiency of the operation as a health institution that covers primary and secondary services health for citizens.

The basic purpose of this paper is to analyze the financial statements as well as the analysis of the financial performance of the organizational units and the public health institution Gostivar Health Center for the period 2017-2021.

The analysis aims to provide basic answers to the main hypothesis and additional hypotheses in terms of ascertaining the causes for the asymmetric financial performance of organizational units (some work with profit and others with loss) despite the fact of the public health institution Gostivar Health Center from the analyzed period 2017-2021 shows a positive financial result.

The paper aims and will recommend organizational and financial reforms in the sense of overcoming the problematic positions in the Balance of the State and increasing the funding from the Health Fund for the necessary health services or the installation of financial participation by citizens and entities that have used these services for free until now.

The author recommends that in addition to financial stabilization, capital investments should be increased, which have minimal levels in the increase of investments with new modern technology, facilities and especially in health equipment in the function of the realization of the most important health services and in time changes in the increase of the quality of human resources (young and qualified medical personnel). The author believes that this study, the first in this institution, exposes the organizational and financial weakness and recommends alternatives for advancing the performance of the institution in question.

## **PËRMBAJTJA:**

|                                                                         |    |
|-------------------------------------------------------------------------|----|
| Hyrje.....                                                              | 9  |
| Kapitulli I .....                                                       | 11 |
| 1. Qëllimi objektivat dhe metodat.....                                  | 11 |
| 1.1. Qëllimi i punimit.....                                             | 11 |
| 1.2. Objektivat e punimit .....                                         | 11 |
| 1.3. Hipotezat.....                                                     | 13 |
| 1.4. Metodrat, teknikat dhe instrumentet e hulumtimit.....              | 13 |
| Kapitulli II .....                                                      | 15 |
| 2. Raportet financiare .....                                            | 17 |
| 2.1. Bilanci i gjendjes.....                                            | 20 |
| 2.2. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.....                        | 31 |
| 2.3. Likuiditeti .....                                                  | 36 |
| 2.4. Treguesi i profitabilitetit .....                                  | 38 |
| 2.5. Treguesi i solventitetit .....                                     | 40 |
| Kapitulli III.....                                                      | 42 |
| 3.1. Struktura e të hyrave dhe shpenzimeve të njësive organizative..... |    |
| 4.1. Konkluzionet.....                                                  | 72 |
| 4.2. Rekomandimet.....                                                  | 74 |
| 4.3. Bibliografia/Referencat.....                                       | 75 |

## **LISTA E TABELAVE**

**Tabela nr.1** Bilanci i gjendjes IPSH Shtëpia e Shëndetit-Gostivar 2017-2021 Aktiva;

**Tabela nr.2** Analiza në strukturë-Bilanci i gjendjes (Aktiva);

**Tabela nr.3** Analiza në strukturë-Bilanci i gjendjes (Aktiva) e propozuar;

**Tabela nr.4** Bilanci i gjendjes IPSH Shtëpia e Shëndetit-Gostivar 2017-2021 pasiva;

**Tabela nr.5** Analiza në strukturë-Bilanci i gjendjes (Pasiva);

**Tabela nr.6** Analiza në strukturë-Bilanci i gjendjes (Pasiva) e propozuar;

**Tabela nr.7** Pasqyra e të hyrave të IPSH Shtëpia e Shëndetit-Gostivar 2017-2021;

**Tabela nr.8** Llogaritja e NKA-NKK;

**Tabela nr.9** Pasqyra e të hyrave e dhe shpenzimeve të laboratorisë specialiste 2017-2021;

**Tabela nr.10** Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve të ndihmës së parë urgjente 2017-2021;

**Tabela nr.11** Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve të shërbimeve sistematike dhe vaksinimi 2017-2021;

**Tabela nr.12** Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve të stomatologjisë preventive për fëmijë 2017-2021;

**Tabela nr.13** Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve të stomatologjisë urgjente 2017-2021;

**Tabela nr.14** Pasqyra e të hyrave e dhe shpenzimeve të patronazhimit 2017-2021;

**Tabela nr.15** Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve të mjekësisë sportive 2017-2021;

**Tabela nr.16** Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve të vizitave shtëpiake 2017-2021;

**Tabela nr.17** Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve të RTG për dhëmbë 2017-2021;

**Tabela nr.18** Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve mesatare 2017-2021;

## **LISTA E FIGURAVE**

- Figura nr.1** Analiza në strukturë bilanci i gjendjes Aktiva;
- Figura nr.2** Analiza dinamike trendi 2021/2017 Aktiva;
- Figura nr.3** Analiza në strukturë bilanci i gjendjes pasiva;
- Figura nr.4** Trendi i shpenzimeve 2021/2017;
- Figura nr.5** Të hyrat e përgjithëshme;
- Figura nr.6** Trendi i shpenzimeve në njësinë laboratorike;
- Figura nr.7** Trendi i të hyrave në njësinë laboratorike;
- Figura nr.8** Trendi i shpenzimeve në njësinë ndihma e parë urgjente;
- Figura nr.9** Trendi i të hyrave në njësinë ndihma e parë urgjente;
- Figura nr.10** Trendi i shpenzimeve në njësinë shqimet sistematike dhe vaksinimi;
- Figura nr.11** Trendi i hyrave në njësinë shqimet sistematike dhe vaksinimi;
- Figura nr.12** Trendi i shpenzimeve në njësinë stomatologjia preventive për fëmijë;
- Figura nr.13** Trendi i të hyrave në njësinë stomatologjia preventive për fëmijë;
- Figura nr.14** Trendi i shpenzimeve në njësinë stomatologjia urgjente;
- Figura nr.15** Trendi i të hyrave në njësinë stomatologjia urgjente
- Figura nr.16** Trendi i shpenzimeve në njësinë patronazhimi;
- Figura nr.17** Trendi i të hyrave në njësinë patronazhimi;
- Figura nr.18** Trendi i shpenzimeve në njësinë mjekësia sportive;
- Figura nr.19** Trendi i të hyrave në njësinë mjekësia sportive;
- Figura nr.20** Trendi i shpenzimeve në njësinë vizita shtëpiake;
- Figura nr.21** Trendi i të hyrave në njësinë vizita shtëpiake;
- Figura nr.22** Trendi i shpenzimeve në njësinë RTG për dhëmbë;
- Figura nr.23** Trendi i të hyrave në njësinë RTG për dhëmbë;



## **1. SFONDI I STUDIMIT**

### **1.1. HYRJE**

Krijimi i një sistemi shëndetësor është një çështje tepër komplekse dhe e ndjeshme si dhe e rëndësishme për çdo vend të botës si dhe krijimi i politikave shëndetësore për funksionimin e këtij sistemi ka një kosto tejet të lartë dhe ka një tendencë sidomos viteve të fundit të periudhës së pandemisë COVID-19 e cila ka një rritje tejet të lartë të kostove për funksionimin e sistemit shëndetësor sepse ka edhe arsye tjera si shfaqja e sëmundjeve të reja, zhvillimi i teknologjisë si dhe kosto tjera për edukim dhe administratë.

IPSH Shtëpia e Shëndetit-Gostivar është themeluar si institucion publik shëndetësor në vitin 2006 kur është bërë ndarja nga Qendër Medicinale në Spital të Përgjithshëm dhe Shtëpi Shëndeti, kryesisht ndarja është bërë, edhe atë:

- Mbrojtja shëndetësore primare
- Mbrojtja shëndetësore sekundare
- Mbrojtja shëndetësore terciare

Ipsht Shtëpia e Shëndetit-Gostivar i takon mbrojtjes shëndetësore primare, duke zhvilluar këto veprimtari edhe atë:

- Ndhmën e parë mjekësore
- Vizitën shtëpiake
- Shiqimet sistematike dhe vaksinimin
- Stomatologjinë preventive të fëmijëve
- Stomatologjinë urgjente
- Patronazhimin
- Mjekësinë sportive
- Laboratorinë specijalistike

Duke marrë parasysh funksionimin e institucionit do të analizojmë pasqyrat financiare si dhe ato buxhetore edhe të hyrave vetaneke.

Të gjitha këto pasqyra së bashku me shënimet dhe vlerësimet e ndryshme që ato përmbajnë, synojnë të japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të IPSH Shtëpia e Shëndetit-Gostivar. Për të realizuar këtë synim pasqyrat financiare duhet të ndërtohen mbi bazën e një sërë supozimesh të përgjithshme si dhe informacioni që ato duhet të sigurojnë, duhet të plotësojë disa karakteristika cilësore nëpërmjet zbatimit të parimeve të kontabilitetit.

## KAPITULLI I

### I. QËLLIMI OBJEKTIVAT DHE METODAT

#### 1.1. Qëllimi i studimit

Duke pasur parasysh se çdo punim apo studim duhet pasur një qëllim në mënyrë që të përcaktohen hapat dhe metodat e realizimit të suksesshëm të punimit, pra qëllimi i realizimit të këtij punimi është analizimi i pasqyrave financiare dhe strukturore .

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të bëj analizën e pasqyrave financiare dhe strukturore në bazë të njësive të Institucionit publik shëndetësor Shtëpia e Shëndetit-Gostivar për vitet 2017-2021, institucion që është i financuar nga mjetet buxhetore si dhe nga mjetet vetanake në bazë të realizimit të shërbimeve shëndetësore si financues i këtyre shërbimeve është Fondi Shëndetësor.

Në këtë punim do të analizohen raportet financiare, siç janë:

- Bilanci i gjendjes dhe
- Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve kumulative si dhe strukturore në kuadër të njësive të institucionit publik shëndetësor Shtëpia e Shëndetit-Gostivar.
- Llogaritja e trendit-bilancit të gjendjes, pasqyrat financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve
- Llogaritja e profitabilitetit (NKA-NKK) të institucionit publik

#### 1.2. Objektivat e punimit

Pas përcaktimit të qëllimit për realizimin e punimit domosdoshmërisht duhet edhe mënyra e realizimit të punimit, edhe atë:

- Analiza në strukturë e bilancit të gjendjes dhe bilancit të ardhurave dhe shpenzimeve

- Analiza dinamike për periudhën 2017-2021 e bilancit të gjendjes dhe bilancit të të ardhurave dhe shpenzimeve
- Analiza e Likuditetit dhe Solventitetit për periudhën 2017-2021
- Llogaritja e aktivitetit dhe profitabilitetit për periudhën 2017-2021
- Analiza e performancës financiare të njësive organizative të IPSH Shtëpia e Shëndetit-Gostivar
- Hulumtimi që ka të bëjë me pasqyrat financiare të IPSH Shtëpia e Shëndetit-Gostivar
- Shfrytëzimi i materialit nga arkivi i institucionit si dhe literatura e shfrytëzuar

## **HIPOTEZAT**

### **Hipoteza kryesore**

Cili është ndikimi i strukturës së bilancit të gjendjes dhe bilancit të suksesit në performancën financiare të IPSH Shtëpia e Shëndetit-Gostivar në kuadër të këndvështrimit pozitiv-negativ në periudhën e analizuar 2017-2021.

### **Hipotezat ndihmëse**

Në cilin nivel ndikon raporti i të ardhurave nga burimet vetanake në raport me të ardhurat e transferuara nga fondi shëndetësor i Maqedonisë së Veriut në performancën financiare të IPSH Shtëpia e Shëndetit- Gostivar ,

Cilat trende manifestoi performanca financiare e IPSH Shtëpia e Shëndetit-Gostivar para, gjatë dhe pas pandemisë Covid-19 në strukturën e të ardhurave dhe shpenzimeve të përgjithshme dhe sipas njësive organizative.

## **METODOLOGJIA E HULUMTIMIT**

Metodologjia e përdorur e hulumtimit është trajtuar në aspektin teorik dhe empirik, duke përmbajtur këto elemente, edhe atë:

- Literaturën e shfrytëzuar
- Analizën e materialit
- Përlllogaritjen e të dhënave të sakta

Në fokus të metodologjisë së hulumtimit do të jenë pyetjet bazë dhe hipotezat që do të testohen, detaje lidhur me përzgjedhjen e popullatës dhe metodën e mbledhjes së të dhënave, strukturën e pyetësorit të përdorur , administrimin e pyetësorit, teknikat, metodat e përgjithshme dhe veçanta shkencore.

Pyetjet bazë të kërkimit për testimin e hipotezave dhe që shërbejnë për orientim dhe qartësim më të thjeshtë e të ndarë të këtij sudimi do të jenë:

- A mendoni se struktura e Aktivës dhe Pasivës të Bilancit të Gjendjes ka ndikim real mbi performancën e IPS Shtëpia e Shëndetit-Gostivar dhe nëse po, atëherë a është ai ndikim pozitiv apo negativ?

- A mendoni se raporti i të hyrave vetanake dhe të hyrave të deleguara nga FSH i Maqedonise së Veriut në Bilancin e Suksestit ka ndikim mbi performancën financiare të IPS Shtëpia e Shëndetit- Gostivar dhe nëse po atëherë a është ai ndikim pozitiv ose negativ?
- Cili është kontributi financiar i njësive organizative të IPSH Shtëpia e Shëndetit- Gostivar në performancën e përgjithshme të këtij institucioni në periudhën e analizuar?
- Cilat trende të performancës financiare të IPSH Shtëpia e Shëndetit-Gostivar u manifestuan para, gjatë dhe pas pandemisë Covid-19 në periudhën e analizuar?

Metodat kryesore të cilat do të përdoren për arritjen e konkluzioneve:

#### **Metodat e përgjithshme shkencore**

- Metoda e analizës, si pjesë e hulumtimit që do të bazohet në pasqyrat financiare, dokumentacionet tjera financiare dhe menaxheriale që do të shfrytëzohen nga arkivet e institucionit publik shëndetësor të cilat do të jenë objekt studimi.
- Metoda statistikore, ku në mënyrë kuantitative do të jepen tabela dhe grafikone me të dhëna për gjendjen aktuale dhe gjendjen në 5 vitet e fundit të institucionit publik shëndetësor.
- Metoda komparative (krahasuese), do të prezantohen rezultatet para pandemisë dhe do të krahasohen me rezultatet gjatë pandemisë, duke vendosur në pah performancën institucionit publik shëndetësor.

#### **Metoda të veçanta shkencore**

- Metoda e analizës dinamike dhe strukturore
- Metoda e treguesve të likuiditetit
- Metoda llogaritjes së NKA dhe NKK
- Metoda e llogaritjes së indeksit dhe raportin e leverixhit financiar

## KAPITULLI II

### 2. Kuptimi mbi kontabilitetin

Kontabiliteti si shkencë daton që në kohërat shumë të vjetra gjatë civilizimit të Sumerianëve në Mesopotami, kur ata kishin nevojë të mbanin evidenca mbi prodhimet e tyre agro-kulturore, gjithashtu kontabiliteti si shkencë ka qenë i nevojshëm për zhvillimin e nevojave shoqërore. Format e para të regjistrimit janë forma primitive të cilat gjendet në civilizimet e vjetra si na Babiloni (3600 p.e.s.) në Kinë në shekullin e I si dhe pastaj në Itali, Luca Pacioli (1445 - 1517), gjithashtu i njohur si Friar Luca dal Borgo llogaritet si themelues i kontabilitetit. Në librin "*Summa de arithmetica, geometrica, proportioni et proportionalita*", në (Venecia në vitin 1494), paraqet sintezën e njohurive matematikore të kohës së tij dhe formulon metodat e mbajtjes së kontabilitetit.

#### Historia e metodave kontabël

- Metoda Italiane
- Metoda Gjermane
- Metoda Amerikane

Kontabiliteti është burim i rëndësishëm i informatave. Informatat kontabiliste i siguron sistemi informativ kontabilist. Kontabiliteti është burim i rëndësishëm i informatave, ndërsa informatat financiare janë të rëndësishme për marrjen e vendimeve nga ana e shfrytëzuesve të atyre informatave. Për këtë arsye, mësimi i kësaj disipline do të kërkojë të njoftohemi me format e ndryshme të organizatave dhe llojet e aktiviteteve që ato i kryejnë. Në këtë kontekst, do të njoftohemi me kontabilitetin si formë e komunikimit me ato të cilët në njëfarë mënyre kanë interes për punën financiare të kompanisë, si edhe me raportet kontabiliste financiare "*Proces i identifikimit, matjes (vlerësimit) dhe këmbimit (komunikimit) të informatave ekonomike, i cili do të mundësojë marrje të vendimeve nga ana e shfrytëzuesve të informatave*"<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Parimet e kontabilitetit financiar , Fitim Deari-Tetovë, 2007

Klasifikimi themelor i shfrytëzuesve të informatave kontabiliste para së gjithash është në:

- shfrytëzues të brendshëm dhe
- shfrytëzues të jashtëm

### **Shfrytëzues të brendshëm**

Shfrytëzuesit e brendshëm para së gjithash janë menaxherët e kompanisë të cilët janë të përfshirë në biznesin e përditshëm.

### **Shfrytëzuesit e jashtëm**

Shfrytëzuesit e jashtëm janë ato të cilët nuk janë drejtpërdrejt të kyçur në operacionet e biznesit, por kanë nevojë për informata të cilat dallohen nga nevojat e shfrytëzuesve të brendshëm

Llojet e kontabilitetit:

- *Kontabiliteti financiar,*
- *Kontabiliteti menaxherial,*
- *Kontabiliteti i kostos,*
- *Kontabiliteti i taksave dhe tatimeve*

**Kontabiliteti financiar** është ajo pjesë e sistemit të kontabilitetit që merret me matjen dhe raportimin e gjendjes financiare dhe të rezultatit të biznesit gjatë një periudhë të caktuar, në përputhje me parimet e përgjithshme të pranura të kontabilitetit.

**Kontabiliteti menaxherial** është përdorues i brendshëm i informacionit në kuadër të një sistemi kontabël i cili shërben për arritjen e objektivave afatshkurta dhe afatgjata të kompanisë.

**Kontabiliteti i kostos** ndihmon për të identifikuar, matur, kontrolluar kostot dhe duke dhënë njëherë informacion për natyrën e kostove.

**Kontabiliteti i taksave dhe tatimeve** paraqet specializim më të ngushtë që mund të realizohet si në kuadër të një entiteti në nivel mikroekonomik ashtu edhe te entitetet publike jo me qëllim fitimi.<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> Kontabiliteti menaxherial Prof.Dr.Rufi Osmani-Tetovë,2008



Standardet e kontabilitetit janë:

- *SKK 01 Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare*
- *SKK 02 Paraqitja e Pasqyrave Financiare*
- *SKK 03 Instrumentet Financiare*
- *SKK 04 Inventarët*
- *SKK 05 Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale*
- *SKK 06 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet e Kushtëzuara*
- *SKK 07 Kontabilizimi i qirave*
- *SKK 08 Të ardhurat - i përmirësuar*
- *SKK 09 Kombinimet e bizneseve dhe Konsolidimi*
- *SKK 10 Grantet dhe forma të tjera të Ndihmës*
- *SKK 11 Tatimi mbi Fitimin*
- *SKK 12 Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit*
- *SKK 13 Aktivet Biologjike dhe marrëveshjet konçesionare*
- *SKK 14 Trajtimi kontabël i Investimeve në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta*

## **2.1.Raportet financiare**

Pasqyrat financiare përgatiten dhe paraqiten për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm nga shumë kompani në të gjitha vendet e botës. Megjithëse pasqyrat e tilla mund të duken të ngjashme nga njëri në tjetrin, ekzistojnë dallime të cilat shkaktohen nga ndryshime e rrethana sociale, ekonomike e ligjore të vendeve të ndryshme. Brenda çdo vendi rregullat e rregullojnë publikimin e pasqyrave financiare. Prezentimi i pasqyrave financiare është i rregulluar me Standardin e Kontabilitetit 1 (SKK ).

Që pasqyrat financiare, si produkt përfundimtar i sistemit kontabël, të mund të përdoren me efektivitet nga përdoruesit e tyre, duhet të plotësojnë disa kritere, të ndërtohen mbi bazën e disa parimeve të cilat janë:

**1. Kuptueshmëria** – sipas kësaj cilësie informacioni i pasqyrave duhet të jetë i kuptueshëm thjesht dhe i shpejtë nga përdoruesit.

**2. Rëndësia** – informacioni ka cilësinë e të qenit i rëndësishëm kur ai influencon vendimet ekonomike të përdoruesve duke i ndihmuar ata të vlerësojnë ngjarjet e kaluara, të tashme e të ardhshme ose që të konfirmojnë vlerësimet e tyre të kaluara.

**3. Besueshmëria** – dobishmëria e informacionit të pasqyrave financiare varet nga shkalla e besueshmërisë së tij. Besueshmëria e informacionit si karakteristikë cilësore varet nga zbatimi i parimeve të mëposhtme:

- a) Paraqitja e sinqertë (vërtetë)
- b) Thelbi mbi formën
- c) Paanshmëria (neutraliteti)
- d) Kujdesi
- e) Plotësia

**4. Krahueshmëria** – informacioni i pasqyrave financiare të një njësie ekonomike duhet të jetë i tillë që t'u sigurojë përdoruesve mundësinë e krahasimit të tij në periudha të ndryshme.

**5. Parimi i vazhdimësisë** – sipas SKK 1, pasqyrat financiare duhet të përpilohen me supozim të vazhdimësisë, d.m.th. kur ndërtohen pasqyrat financiare duhet supozuar që biznesi do të vazhdojë të funksionojë pak a shumë në formën që e ka aktualisht edhe për një periudhë të caktuar në të ardhmen

**6. Koncepti i përputhjes** dikton që të gjitha të hyrat dhe shpenzimet duhet të njihen atëherë kur ato ndodhin, e jo kur arkëtohet apo paguhet.

**7. Konventa e konzervatizmit** – thotë se aty ku ka procedura alternative, apo vlerësime alternative, duhet zgjedhur atë e cila ofron një prezantim më të matur të rezultatit financiar apo pozitës financiare të biznesit.

**8. Konventa e konsistencës (Qëndrueshmërisë)** – nënkupton faktin se parimet dhe rregullat e shfrytëzuara në kontabilitet nuk duhen ndryshuar nga viti në vit për shkak të pamundësisë së krahasimit të rezultateve.

**9. Parimi i veçimit të qenies nga biznesi** – kontabilistët e konsiderojnë biznesin si një entitet të ndarë nga pronari apo drejtuesit. Parimi zbatohet pa marrë parasysh se a është një kompani me përgjegjësi të kufizuar apo si kompani me pronar të vetëm apo shoqëri aksionare.

**10. Parimi i matjes përmes vlerës monetare** – në bilancin e gjendjes së një biznesi, vlera monetare mund t'i mvishet pasurive si makinave dhe stokeve të mallit.

**11. Parimi i vlerësimeve të veçuara** – ky parim dikton, që përcaktimi i vlerës apo detyrimi në bilancin e gjendjes, për të gjithë përbërësit duhet të bëhet ndaras.

**12. Konventa e materialit** – një gabim i cili është shumë i parëndësishëm që të ndikojë në kuptimin e ndonjë llogarie konsiderohet si jomateriale. Gjatë përgatitjes së llogarive me rëndësi është që të vlerësohet se çka është materiale e çka jo, ashtu që të mos humben koha dhe paratë në kërkim të hollësive. Në kontabilitet, koncepti i materialitetit ka të bëjë me rëndësinë relative të të dhënave ekonomike. Në kuptimin kontabël, një objekt, informacion është material në qoftë se ai është i dobishëm ose i rëndësishëm për përdoruesit e informacionit të një pasqyre financiare në marrjen e një vendimi të caktuar.

**13. Parimi i kostos historike** – një parim themelor është ai sipas të cilit burimet regjistrohen në kontabilitet me koston historike, p.sh. vlera të cilën kompania e pagoi për blerjen e tyre.

**14. Njësi monetare e qëndrueshme** – pasqyrat financiare duhet të shprehen në njësi monetare, me supozim se kjo njësi monetare do të jetë e qëndrueshme. Pra duke supozuar se nuk do të ketë inflacion ose deflacion të asaj valute, në të kundërtën do të rezultojë në pasqyra financiare jo reale dhe të pakrahasueshme prej vitit në vit.

**15. Koncepti i objektivitetit** – një kontabilist duhet të shfaq objektivitet në punë. Kjo do të thotë se ai duhet që përgjigjet e veta t'i zhvesh nga paragjykimet e veta personale dhe ato t'i ketë të skata dhe të hollësishme aq sa sigurojnë rrethanat.

**16. Parimi i realizimit** – të hyrat dhe fitimi nuk parashikohen por njihen duke i përfshirë në llogarinë e të hyrave dhe shpenzimeve vetëm pasi që fitohen apo shpenzohen, ose edhe ndonjë pasuri tjetër, realizimi monetar i të cilit mund të matet me një siguri të arsyeshme.

**17. Pranimi i të hyrave** – kontabiliteti akrual bazohet në bashkërendimin e të hyrave me kostot nga të cilat rrjedhin.

**18. Koncepti i hyrjeve të dyfishta** – secili transaksion i ka dy efekte. Kjo konventë përforcon llogarimbajtjen e dyfisht.

**19. Përmbajtja sipër formës** – do të thotë se transaksionet duhet të trajtohen dhe paraqiten në përputhje me përmbajtjen e tyre ekonomike, e jo me formën e tyre ligjore<sup>3</sup>.

Raportet financiare paraqesin fazën përfundimtare të procesimit të të dhënave të kontabilitetit dhe paraqiten si bartës të informatave kontabile.

Klasifikimi i raporteve financiare janë:

- Bilanci i gjendjes
- Bilanci i suksesit
- Bilanci tatimor
- Raporti i rrjedhjes së parave

Raportet financiare ofrojnë informacion mbi gjendjen financiare, suksesin dhe rrjedhjen e parasë, përgjegjësinë për përgaditjen dhe paraqitjen e raporteve financiare e mbanë udhëheqësia e institucionit.

## **2.2. Bilanci i gjendjes**

Bilanci i gjendjes është një përmbledhje e sistemuar që pasqyron gjendjen e pasurisë së kapitalit e të detyrimeve të ndërmarrjes.

Fjala bilanc rrjedh nga fjala latine “bilanx” që d.m.th. dy tasa, apo ka mendime se fjala bilanc del nga shprehja “libra bilanxe” apo peshore me dy tasa.

Elementet kryesore të bilancit të gjendjes janë:

**Pasuria**-pasuria është resurs i cili rrjedh nga aktivitetet e ndërmarrjes

Elementet bazë të përcaktimit të pasurive janë:

- Kontrolli – me kontroll ekonomik kuptohet zotërimi nga ana e njësisë ekonomike i përfitimeve të siguruara nga një aktiv.

---

<sup>3</sup> Kontabiliteti, Vëllimi i dytë Nada Jovanova, 2013 Veles

- Përfitimet e ardhshme ekonomike, të cilat janë potenciali që ka për të kontribuar aktiv, direkt apo indirekt në rrjedhën e parave apo ekuivalentëve të tyre në njësi.

Pasuria klasifikohet si pasuri qarkulluese (afatshkurtër), pasuri jo qarkulluese (afatgjatë) dhe pasuri të paprekshme.

Në pasuritë qarkulluese hyjnë:

- Paraja e gatshme (Cash)
- Depozitat në bankë
- Parapagimet
- Llogaritë e arkëtueshme (neto)
- Stoqet
- Investimet afatshkurtëra
- Në pasuritë themelore hyjnë:
- Makineritë
- Pajisjet
- Objektet (Ndërtesat)
- Toka
- Investimet afatgjata
- Në pasuritë e paprekshme hyjnë:
- Patenta
- Lincenca
- Franshiza
- Godd will-i
- E drejta e autorit

**Detyrimet**-janë borxhi ekzistues i ndërmarrjes i cili zvogëlon pasurinë, një detyrim është një obligim i tanishëm i njësisë ekonomike i lindur nga ngjarje të kaluara, shlyerja e të cilit do të sjellë si rezultat një dalje nga njësia të burimeve që përmbajnë përfitime ekonomike.

Detyrimi duhet të klasifikohet si detyrim afatshkurtër kur:

- a) Pritet që të shlyhet gjatë kohëzgjatjes normale të ciklit veprues së ndërmarrjes, ose

- b) Pritet që të shlyhet brenda 12 muajve nga data e shënuar në pasqyrën e bilancit, të gjitha detyrimet tjera duhet të klasifikohen si detyrime afatgjata.

Në detyrime afatshkurtëra hyjnë:

- Mbitërheqja bankare
- Llogaritë e pagueshme
- Pagat e pagueshme
- Tatimi i pagueshëm
- Shpenzimet akruale
- Të hyrat e pafituara
- Të pagueshmet tjera
- Kreditë afatshkurtër
- Në detyrimet afatgjata hyjnë:
- Kreditë afatgjata
- Obligacionet Një detyrim njihet në bilanc kur të plotësohen kushtet e mëposhtme:
- Kur është e mundur që një dalje e burimeve të cilat bartin përfitime ekonomike, do të rezultojë nga shlyerja e një obligimi aktual dhe
- Shuma në të cilën shlyerja do të kryhet mund të matet në mënyrë të besueshme

**Kapitali**-Pjesa e mbetur e pasurisë pas zbritjes së të gjitha detyrimeve nëse është biznes individual quhet kapital i vet, nëse është shoqëri aksionare quhet kapital aksionar, faktikisht është ndryshim në mes pasurisë dhe detyrimeve, e që paraqet detyrimin e kompanisë ndaj pronarit apo pronarëve<sup>4</sup>.

Elementet përbërse të ekuitetit janë:

- a) Kapitali i emetuar (aksionet e zakonshme dhe preferenciale)
- b) Rezervat
- c) Fitimi i mbajtur

---

<sup>4</sup> Kntabiliteti Financiare në Prof.dr. Sc. Skender Ahmeti-2007 Prishtinë

Ekuacioni themelor i kontabilitetit është

$$\text{Pasuria} = \text{Detyrimet} + \text{Ekuiteti}$$

Prej nga rrjedhin këto ekuacione:

$$\text{Ekuiteti} = \text{Pasuria} - \text{Detyrimet}$$

$$\text{Detyrimet} = \text{Pasuria} - \text{Ekuiteti}$$

Bilanci i gjendjes mund të paraqitet në dy forma: horizontalisht ose vertikalisht.

Në bazë të ligjit për Kontabilitet në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe planit të përgjithshëm Kontabël.

**Tabela 1 Bilanci i gjendjes IPSH Shtëpia e shëndetit Gostivar 2017-2021 Aktiva**

| Pershkrimi                      | 2017        | 2018        | 2019       | 2020       | 2021        | Trendi<br>2021/2017 |
|---------------------------------|-------------|-------------|------------|------------|-------------|---------------------|
| AASH                            | 53,652,324  | 53,552,797  | 48,121,773 | 42,699,340 | 47,754,900  | -10.99%             |
| Para të gatshme                 | 102,004     | 184,624     | 1,037,566  | 651,532    | 7,101,087   | 6.861.58%           |
| Arka                            | 252         | 252         | 252        | 252        | 252         | 0.0%                |
| Kërkesa nga buxh.               | 8,347,053   | 8,345,981   | 8,249,275  | 8,436,081  | 8,441,981   | 1.14%               |
| Kërkesa nga blerësit vendas     | 4,307,752   | 4,783,392   | 4,860,877  | 5,519,703  | 5,089,305   | 18.14%              |
| Kërkesa nga shteti              |             |             |            |            | 39,028      | 0.0%                |
| NKA                             | 30,053,380  | 29,396,665  | 23,131,920 | 17,249,889 | 16,241,364  | -45.96%             |
| Marredh. Finan.                 | 10,841,883  | 10,841,883  | 10,841,883 | 10,841,883 | 10,841,883  | 0.0%                |
| AAGJ                            | 95,722,125  | 52,346,251  | 50,765,420 | 49,052,095 | 54,324,150  | -43.25%             |
| Prona dhe ndërtesa              | 52,605,084  | 39,210,096  | 38,953,613 | 38,979,364 | 43,941,020  | -16.47%             |
| Pajisje dhe makineri            | 37,056,577  | 5,040,171   | 4,404,618  | 1,701,875  | 1,289,232   | -96.52%             |
| Materijalet dhe inventar i imët | 6,060,464   | 8,095,984   | 7,407,189  | 8,370,856  | 9,093,898   | 50.05%              |
| Gjithsej                        | 149,374,449 | 105,899,048 | 98,887,193 | 91,751,435 | 102,079,050 | -31.66%             |

**Burimi :** Përpunuar nga autori në bazë të pasqyrave financiare bilanci i gjendjes të IPSH Shtëpia e Shëndetit-Gostivar

Duke analizuar trendin komulativ në bilancin e gjendjes ku kemi një ulje të dukshme të aktivës si pasojë e uljes si AAGJ konkretisht zhvlerësimit të pronës dhe pajisjeve kurse në vitin 2021 kemi rivlerësim. Gjithashtu vlen të theksohet edhe ulja e NKA sepse kemi zvogëlim të obligimeve. Dy janë pozicione problematike në strukturën e aktivës: Marrëdhëniet financiare të

llogaritura në shumë prej 10,841,883 denarë që është shuma e njejtë që ka mbetur si pozicion fiktiv dhe që duhet të shlyhet me vendim të Agjencionit për Prokurim Shtetëror sepse është pozicion që rrit aktivën për 10% ndërsa në realitet është aktiv inekzistent.

Pozicioni i dytë është zvoglimi enorm i pajimeve dhe maqinerive që ka evidentuar zvoglim për 97% si pasojë e amortizimit dhe mosinvestimit në pajime dhe teknologji të reja si pasojë e mungesës së financimeve shtesë dhe stabilitetit të brishtë financiar të institucionit.

Pikërisht këto dy pozicione argumentojnë hipotezën kryesore se aktiva e institucionit publik ka strukturë joadekuatë të aktivës së shoqëruar me strukturë joadekuatë edhe të pasivës që rezikon funksionalitetin efektiv të institucionit publik që e ka prodhuar si pasojë zvoglimin e aktivës për 31,7% në periudhën e analizuar.




**Tabela 2 :Analiza në strukturë-Bilanci i gjendjes (Aktiva)**

| Analiza në strukturë        | Viti | Aktiva        |        |
|-----------------------------|------|---------------|--------|
| <b>Totali i aktivës</b>     | 2017 | 149.374.449   | 100%   |
| <b>AAGJ</b>                 | 2017 | 95.722.125    | 64%    |
| <b>Mjetet në para</b>       | 2017 | 102.256       | 0,06%  |
| <b>Kërkesat</b>             | 2017 | 53.550.068    | 35,94% |
| <b>Analiza në strukturë</b> | Viti | <b>Aktiva</b> |        |
| <b>Totali i aktivës</b>     | 2018 | 105.899.048   | 100%   |
| <b>AAGJ</b>                 | 2018 | 52.346.251    | 49,83% |
| <b>Mjetet në para</b>       | 2018 | 184.876       | 0,17%  |
| <b>Kërkesat</b>             | 2018 | 53.367.921    | 50%    |
| <b>Analiza në strukturë</b> | Viti | <b>Aktiva</b> |        |
| <b>Totali i aktivës</b>     | 2019 | 98.887.193    | 100%   |
| <b>AAGJ</b>                 | 2019 | 50.765.420    | 51,3%  |
| <b>Mjetet në para</b>       | 2019 | 1.037.818     | 1,%    |
| <b>Kërkesat</b>             | 2019 | 47.083.955    | 47,7%  |
| <b>Analiza në strukturë</b> | Viti | <b>Aktiva</b> |        |
| <b>Totali i aktivës</b>     | 2020 | 91.751.435    | 100%   |
| <b>AAGJ</b>                 | 2020 | 49.052.095    | 53,4%  |
| <b>Mjetet në para</b>       | 2020 | 651.784       | 0,7%   |
| <b>Kërkesat</b>             | 2020 | 42.047.556    | 45,9%  |
| <b>Analiza në strukturë</b> | Viti | <b>Aktiva</b> |        |
| <b>Totali i aktivës</b>     | 2021 | 102.079.050   | 100%   |
| <b>AAGJ</b>                 | 2021 | 54.324.150    | 53%    |
| <b>Mjetet në para</b>       | 2021 | 7.101.339     | 7%     |
| <b>Kërkesat</b>             | 2021 | 40.653.561    | 40%    |

**Burimi** : Përpunuar nga autori në bazë të bilancit të gjendjes të IPSH Shtëpia e shëndetit Gostivar

Duke treguar analizën në struktur të bilancit të gjendjes gjegjësisht aktivës shihet qart se kemi ulje të aktivës, ulje të kërkesave dhe vitin e fundit kemi një rritje enorme të mjeteve në para në krahasim me vitet paraprake që janë në nivel tejet të ulët.




**Figura 1 Analiza në strukturë bilanci i gjendjes aktiva**

**Burimi** : Përpunuar nga autori në bazë të bilancit të gjendjes të IPSH Shtëpia e Shëndetit-Gostivar

### Analiza dinamike

|                          |                             |                    |                     |
|--------------------------|-----------------------------|--------------------|---------------------|
| <b>Aktiva 2021</b>       | <b>102.079.050</b>          | <b>Aktiva 2020</b> | <b>91.751.435</b>   |
| <b>Trendi 2021/2020</b>  | 102.079.050-91.751.435      |                    | <b>10.327.615</b>   |
| <b>Trendi 2021/2020</b>  | 10.327.615/91.751.435x100   |                    | <b>11% rritje</b>   |
| <b>Aktiva 2020</b>       | <b>91.751.435</b>           | <b>Aktiva 2019</b> | <b>98.887.193</b>   |
| <b>Trendi 2020/2019</b>  | 91.751.435-98.887.193       |                    | <b>-7135758</b>     |
| <b>Trendi 2020/20219</b> | -71.35.758/98.887.193x100   |                    | <b>-7% zvoglim</b>  |
| <b>Aktiva 2019</b>       | <b>98.887.193</b>           | <b>Aktiva 2018</b> | <b>105.899.048</b>  |
| <b>Trendi 2019/2018</b>  | 98.887.193-105.899.048      |                    | <b>-7.011.855</b>   |
| <b>Trendi 2019/2018</b>  | -7.011.855/105.899.048x100  |                    | <b>6% zvoglim</b>   |
| <b>Aktiva 2018</b>       | <b>105.899.048</b>          | <b>Aktiva 2017</b> | <b>149.374.449</b>  |
| <b>Trendi 2018/2017</b>  | 105.899.048-149.374.449     |                    | <b>-4.347.5401</b>  |
| <b>Trendi 2018/2017</b>  | -43.475.401/149.374.449x100 |                    | <b>-29% zvoglim</b> |



**Figura 2 Analiza dinamike trendi 2021/2017 Aktiva**

**Burimi :** Përpunuar nga autori në bazë të pasqyrave financiare bilanci i gjendjes të IPSH Shtëpia e shëndetit Gostivar

Duke marrë parasysh trendin tek aktivet afatshkurtra kemi rritje të parave të gatshme 7% në krahasim me vitet paraprake, kurse tek aktivet afatgjate kemi zhvlerësim të pronës dhe pajisjeve për arsye se si objektet poashtu edhe pajisjet janë të vjetëruara dhe pjesa më e madhe është amortizuar nga viti 2017 deri në vitin 2020, njëkohësisht kemi edhe zhvlerësim të dukshëm, kurse në vitin 2021 kemi rivlerësim si të pronës edhe të pajisjeve, kurse kërkesat nuk kanë ndonjë ndryshim të madh përveç ndarjeve kohore aktive si pasojë e uljes së borxhit nga

blerësit. Pozicion në bilansin e gjendjes në aktivë, marrëdhëniet financiare të llogaritura janë diskutabile në bazë të analizës së bërë ai pozicion është i trashëguar nga ndarja e qendrës medicinale në dy subjekte të ndara edhe atë Spital i Përgjithshëm dhe Shtëpi Shëndeti. Gjithashtu edhe pozicioni kërkesat nga buxheti është pozicion diskutabil sepse në bazë të analizës financiare dhe informatave kontabël të dy pozicionet duhet fshirë, në atë moment kemi analizë në strukturë të bilancit të gjendjes, gjegjësisht aktiva do të ndryshojë dhe do të jap një sugjerim për fshirjen e këtyre pozicioneve sepse do kemi një bilanc të gjendjes reale dhe të saktë, ku do paraqes edhe një analizë në strukturë të bilancit të gjendjes-aktiva. Gjithashtu mund të theksojmë se parat e gatshme në nivel me aktivën janë tejet të ulta kurse në vitin 2021 kemi një ngritje drastike në krahasim me vitet e mëparshme.

**Tabela 3: Analiza në strukturë-Bilanci i gjendjes (Aktiva) e propozuar**

| Analiza në strukturë | Viti | Aktiva      |        |
|----------------------|------|-------------|--------|
| Totali i aktivës     | 2017 | 130.152.513 | 100%   |
| AAGJ                 | 2017 | 95.722.125  | 73.54% |
| Mjetet në para       | 2017 | 102.256     | 0,07%  |
| Kërkesat             | 2017 | 34.361.132  | 26,39% |
| Analiza në strukturë | Viti | Aktiva      |        |
| Totali i aktivës     | 2018 | 86.711.184  | 100%   |
| AAGJ                 | 2018 | 52.346.251  | 60.36% |
